



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2009

SESIONI I

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe
Gjimnazi – drejtimi shoqëror; drejtimi i përgjithshëm

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve. Për rastet kur përgjigja e nxënësit nuk përshtatet plotësisht me përgjigjen në skemë, por afron me logjikën e pyetjes, komisioni i vlerësimit është i detyruar të këshillohet me drejtuesin teknik dhe me specialistët e AVA, për të bërë vlerësimin përfundimtar.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* është specifikuar me kujdes. Vlerësimi i saj do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Migjeni****“Baladë qytetse”**

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	C	1 pikë
Pyetja 7	B	1 pikë

Pyetja 8 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Po. Sfondi i natës, ku zhvillohet ngjarja e kësaj poezie, krijon një efekt emocional të fortë dhe nxit përfytyrime të drejtpërdrejta dhe të figurshme:
Në këtë sfond errësire, qetësie të plotë, ku të pranishme janë vetëm *yjet dhe hënën*, drama që po përjeton kjo grua merr përmasa të tjera. Braktisja dhe indiferenca që e rrethon shkaktojnë efekte të forta të lexuesi.
- Errësira e natës sillet paralel me fatin e gruas (transformimi fizik dhe shpirtëror i saj shkakton ndjesi emocionale).
- Nata dhe yjet janë dëshmitare të indiferencës (kriminalitetit) të shoqërisë ndaj gruas.
- Nata, fantoma, varri (kuptimi figurativ) rrisin dramacitetin e figurës së gruas.
- Nata ka njëfarë misteri si dhe vetë jeta e saj.

Pikë të plota

2 pikë Nëse shpjegon qartë dhe plotë thelbin e kësaj zgjedhjeje nga ana e poetit duke theksuar dy momente: interpretimi i vetë natës (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose figurative) dhe ana emocionale që shkakton kjo zgjedhje të lexuesi.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse shpjegon pjesërisht rëndësinë e kësaj zgjedhjeje nga ana e poetit.

- Po, sepse natën gjërat bien më shumë në sy.
- Po, sepse nata është më emocionuese.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë ,shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 9 **3 pikë****Model përgjigjeje**

Dy planet janë: mjerimi fizik dhe ai shpirtëror.

Vargu ku këto dy plane jepen të shkruara në një është:

me veshje dhe me shpirt të grisun,

Pikë të plota

2 pikë Nëse identifikon të dy planet në të cilat përshkruhet kjo grua.

DHE

1 pikë Nëse identifikon vargun ku mjerimi fizik dhe shpirtëror shkrihen në një.

Pikë të pjesshme

2 pikë Nëse identifikon vetëm të dy planet në të cilët përshkruhet kjo grua.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një plan në të cilët përshkruhet kjo grua.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm vargun ku mjerimi fizik dhe shpirtëror shkrihen në një.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **4 pikë****Model përgjigjeje**

a) Në këtë poezi veprimi zhvillohet në **dy kohë**: të shkuarën (të pakryerën dhe të kryerën e thjeshtë) dhe të tashmen.

b) Nënteksti:

- Kjo grua ka një të shkuar, që po i dikton edhe një të tashme, por nuk dihet nëse do të ketë të ardhme.
- Kjo grua ka një të shkuar, ka një të tashme, por nuk ka të ardhme.
- Jeta e kësaj gruaje ka një të djeshme që fillon që kur ishte e re dhe deri mbrëmë, si dhe një të tashme.

c) Alternimi i vargut të gjatë me vargun e shkurtër:

- tërheq vëmendjen në idetë që do të përcjellë poeti. OSE
- i jep ritëm poezisë. OSE
- krijon imazhin e një valleje të çmendur.

Pikë të plota

2 pikë a) Nëse identifikon dy kohët në të cilat zhvillohet veprimi.

- Të shkuarën (e kryer e thjeshtë dhe e pakryer) dhe të tashmen.

1 pikë b) Nëse shpjegon nëntekstin e këtij përdorimi.

1 pikë c) Nëse shpjegon përse shërben teknika e alternimit të vargut të gjatë me vargun e shkurtër në poezi.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse identifikon vetëm një nga kohët në të cilën zhvillohet veprimi.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon përse shërben teknika e alternimit të vargut të gjatë me vargun e shkurtër në poezi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, përmend arsye që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 11 4 pikë**Model përgjigjeje**

a) **Figura e stilistikës:** epiteti (ose epiteti metaforik).

b) **Imazhi i krijuar është:**

- ai i një gruaje të shkatërruar fizikisht dhe moralisht: të varfër, të lodhur, të përbuzur, të braktisur, të mjerë, të çmendur, të sflitur, të trishtuar etj.
(Do të pranohen edhe citime të drejtpërdrejta të epiteteve nga fragmenti).

c) **Kontrastet:**

- Gruaja dikur e re, e bukur, në lulëzim—sot e mjerë, e shkatërruar, e plakur.
- Gruaja vuan - qyteti është indiferent, njerëzit janë të largët.
- Vallja i takon njeriut të lumtur – në këtë poezi bëhet pjesë e gjendjes shpirtërore të një njeriu të mjerë.
- Vallja e zakonshme me ritëm të rregullt dhe harmonike- kjo valle e çrregullt dhe joharmonike.

Pikë të plota

1 pikë a) Nëse gjen figurën e stilistikës.

DHE

1 pikë b) Nëse shpjegon thelbin e imazhit të saj që paraqitet pikërisht përmes epiteteve të thjeshta dhe epiteteve metaforike.

DHE

1 pikë c) Nëse gjen dy raste kundërvëniesh.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse gjen figurën e stilistikës.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon thelbin e imazhit të saj që paraqitet pikërisht përmes epiteteve të thjeshta dhe epiteteve metaforike.

OSE

1 pikë Nëse gjen një rast kundërvëniesh.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 3 pikë**Model përgjigjeje**

Vargjet ku shprehet revolta e Migjenit janë:

Jeta e saj asht kjo vall' e çmendun
në rrugat e qytetit tonë,
një jetë e fikun, një jetë e shterun,
shpirt i molisun, zemër e therun,
një za vorri, një jehonë
që vallzon natën vonë
nëpër rrugët e qytetit tonë.

Në strofën e fundit ndihet revolta e poetit. Kjo revoltë është jo e drejtpërdrejtë, por shfaqet më shumë përmes fjalëve kyç: **e çmendun, e fikun, e shterun, i molisun, e therun, një za vorri, një jehonë.**

1 pikë Nëse zbulon vargjet (i citon ose identifikon të fundit).

DHE

1 pikë Nëse gjen se kjo revoltë është e tërthortë.

DHE

1 pikë Nëse gjen disa fjalë kyç (një ose më shumë se një)

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton pse kjo është një poezi e trishtuar;
- përqendrohet në disa nga momentet që e bëjnë atë të tillë si dhe rolin që ka luajtur figuracioni dhe detajet e përzgjedhura nga poeti në krijimin e saj.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga poezia.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
hyrjen
zhvillimin
përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.

PJESA II

Franc KAFKA

“Metamorfoza”

Pyetja 14	B	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	A	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë
Pyetja 19	D	1 pikë

Pyetja 20 3 pikë

Model përgjigjeje

a) Metamorfoza simbolizon:

- transformimin ose tjetërsimin personal të Gregorit, si pasojë e efekteve të punës së tij vdekjeprurëse.

OSE

- transformimin e Gregorit për shkak të problemeve të shumta në familjen e tij, të cilat i kanë atij marrë frymën.

OSE

- shkallën më të lartë të vetmisë, zhgënjimit dhe tjetërsimit njerëzor në kushtet e një shoqërie të ashpër dhe armiqësore.

OSE

- transformimin e Gregorit si pasojë e ushtrimit të autoritetit arbitrar brenda familjes.

OSE

- transformimin dinamikës së jetës në familjen e Gregorit.

b) Qëllimi i fjalisë së parë është ta tronditë lexuesin. Në kështu e dimë që në fillimi se nuk mund të parashikojmë dot asgjë se ç’ mund të ndodhë në këtë histori. Në mënyrë të ftohtë, pa asnjë emocion, ajo shpreh një transformim të përbindshëm si diçka tepër normale dhe të zakonshme.

Gjithashtu nga fjalia ne kuptojmë se vetë Kafka nuk merr përsipër të na thotë se është e mundur që dikush të shndërrohet në një insekt, por të tregojë se vetë letërsia nuk ka nevojë të nderojë ligjet e natyrës. Kështu historia trajton një ngjarje të pamundur brenda një logjike të caktuar.

1 pikë Nëse shpjegon saktë dhe nisur nga thelbi i veprës se ç’ simbolizon metamorfoza e Gregorit .

DHE

2 pikë Nëse shpjegon qartë dhe saktë pse fjalia hyrëse është vlerësuar nga kritika si tronditëse dhe e famshme.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon pjesërisht të veçantën që ka kjo fjali.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modelin e përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 **3 pikë****Model përgjigjeje****a) Arsyet janë:**

- Kandrrat shikohen nga ne si të parëndësishme. (Nëse i thua dikujt je një mizë, një milingonë etj është njësoj si t'i thuash që je i parëndësishëm.)
- Kandrrat janë, gjithashtu, të pështira, të neveritshme që duhen zhdukur, shfarosur. Transformimi i Gregorit shkakton shumë pështjellim rreth e qark: ai nuk është thjesht i frikshëm dhe i neveritshëm, por gjithashtu nxit pështirosje te të tjerët.

b) A e kupton Gregori rëndësinë e transformimit?

- Jo. Ai dështon plotësisht të kuptojë se çka ndodhur realisht me të. Atë e shqetëson më shumë si të ngrihet nga krevati apo se po bëhet vonë për në punë.
- Gregori është i vetmi personazh në novelë, që nuk ndikohet emocionalisht nga transformimi që i ka ndodhur.
- Gregori mbetet indiferent në lidhje me transformimin e vet.

Pikë të plota

2 pikë Nëse gjen dy arsye pse Kafka e ka transformuar Gregorin në një zvarranik.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon se a e kupton Gregori rëndësinë e transformimit.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse gjen një arsye pse Kafka e ka transformuar Gregorin në një zvarranik.
OSE

1 pikë Nëse shpjegon sa e kupton Gregori rëndësinë e transformimit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim (nuk ka kuptuar thelbin e veprës) ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 22 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Momente:

- Gregori është shndërruar në zvarranik, por sjelljet dhe mendimet e tij janë të një njeriu normal.
- Dhoma ku jeton Gregori.
- Detaje të jetës së tij në dhomë.
- Detaje të mjedisit (tavolina, krevati, dritarja, moti).
- Marrëdhënia me nënën (ajo vjen ta zgjojë).
- Shqetësimi i tij për t'u ngritur në kohë.
- Marrëdhënia me punëdhënësin.
- Etj

2 pikë Nëse gjen dy detaje që e bëjnë këtë histori fantastike të besueshme.

DHE

1 pikë Nëse gjen vetëm një detaj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Gregori ka krijuar me kohë një distancë nga gjithçka njerëzore (paragrafi II – “*dhoma e tij e vërtetë për një qenie njerëzore*” shpreh distancë).
- Gregori e shikon profesionin e tij si diçka jo të rëndësishme (kalimthi thuhet se është komisioner tregtie). Ai është pjesë e një ekonomie që i kushton më shumë vëmendje fitimit se sa njeriut.
- Gregori është prej shumë kohësh i izoluar në dhomën e tij, i shkëputur nga të tjerët.
- Gregori mendon vetëm për familjen e tij dhe punën dhe e ka injoruar plotësisht veten e tij (ai ndihet i shkëputur nga trupi njerëzor, për sa kohë as transformimi s'i bën asnjë përshtypje).
- Gregori e urren punën (nënkuptohej kur shpreh bezdinë e tij në fund të këtij fragmenti kundrejt prokuratorit) dhe kjo është jo thjesht rezultat i një dite, por i një procesi të zgjatur në kohë.
- Gregori është prej kohësh nën një presion kohe, që i programon gjithçka dhe e shkëput nga vetja e tij (zgjohet çdo ditë herët etj).
- (Do të pranohet edhe referimi në vepër në lidhje ndikimin e familjes në transformimin e tij.)

2 pikë Nëse identifikon dy rrethana të jetës së Gregorit.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një rrethanë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një interpretim që nuk e përmban modelin e përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24 **1 pikë****Model përgjigjeje**

- Ora përmendet disa herë në këtë fragment. Koha simbolizon rregullin në një shoqëri në të cilën koha është para dhe si e tillë ka vlerë.
- Ajo tregon hapësirën në të cilën rregullat e një shoqërie moderne peshojnë mbi Gregorin: koha që nuk shfrytëzohet për të punuar nuk ka asnjë vlerë.
- Ajo tregon pushtetin e shoqërisë mbi të dhe varësinë e tij nga shoqëria.

1 pikë Nëse shpjegon nëntekstin e përdorimit të orës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 **2 pikë****Model përgjigjeje****a) Situata absurde**

- Situata irracionale dhe e frikshme në të cilën gjendet Gregori.
- Gërshetimi i transformimit të tij në zvarranik me anë të tjera normale dhe reale.

b) Shpjegimi

- Është situatë absurde, pasi një transformim kaq i paimagjinueshëm jepet në mënyrë krejt normale dhe si diçka e zakonshme.

Do të pranohen edhe citime direkt nga fragmenti.

Pikë të plota

1 pikë Nëse gjen një situatë absurde.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon pse është e tillë.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse gjen një situatë absurde.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon pse është e tillë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, gjen situata të tjera absurde që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.